

Data 02.09.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi internetit për një periudhë 3 vjeçare”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT- 72400000-4 -
Shërbimet e internetit

VLERA E FONDIT LIMIT:

- 119,248,680 (Njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë, pa TVSH.
- 1,192,129.16 (një milion e njëqind e nentëdhjetë e dy mijë e njëqind e njetë pike gjashtëmbëdhjetë) euro pa TVSH. Referuar kursit të këmbimit të B.SH datë 30.08.2024 1 euro = 100.03 All.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor OSHEE GROUP SH.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020 i ndryshuar , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “OSHEE GROUP” sh.a. ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Ne zbatim te Paragrafit 2, Pika 1, e Nenit 39 te LPP, Njesia e Prokurimit sqaron se, nuk ka perzgjedhur ndarjen ne Lote te procedures se prokurimit per sherbimin e internetit per arsye se kjo procedure eshte e pamundur teknikisht te ndahet ne kontrata te ndryshme. Realizimi i ketij sherbimit do të kontrollohet dhe monitorohet nga OSHEE Group sh.a/DTI. Autoriteti kontraktor ka vendosur te zhvilloje kete procedure pa ndare ne lote per shkak se synon te perfitoje sherbimin ne nje kohe sa me te shpejte, pa vonesa me qellim garantimin e mbarevajtjes se punes dhe plotesimit te kerkesave te perditshme te punes. Duke qene se kemi te bejme me nje sherbim me shtrirje te gjere teritoriale, autoriteti kerkon te finalizojë nenshkrimin e nje kontrate me nje operator, cka do te sillte edhe menaxhimin sa me te thjeshte dhe me te shpejte te kontrates dhe rrjedhimisht edhe perfitimn e sherbimit brenda afateve te kerkuara, pa vonesa dhe pa burokraci.

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 33, të ligjit 10091 datë 05.03.2009 i ndryshuar “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **119,248,680 (Njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë)** leke pa TVSH.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pikat 1, 2, dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e shërbimit dhe vlerën e konsiderueshme të fondit limit të kësaj kontrate, kompleksitetin e produkteve dhe shërbimeve, sasinë dhe cilësinë e tyre, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta

realizuar atë ne kohe dhe ne përputhje me specifikimet teknike te kërkuara. Për këtë arsye, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik ndaj është argumentuar se vlera mesatare e xhiros për tre apo me pak vitet e fundit financiare te jete ne masën **119,248,680 (Njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë)** leke pa TVSH.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 13 pika 2: *“Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi”*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, Ligji nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe në zbatim të Nenit 41, pika c, të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë afersisht sa 30 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë faktin që të krijohen kushtet për një konkurrencë të hapur dhe për të mos minimizuar artificialisht numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje shërbimesh, pavarësisht rëndësisë dhe kompleksitetit të shërbimeve objekt procedure prokurimi, bazuar dhe në frymën e konkurrencës që gjeneron LPP 162/2020 është gjykuar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë/realizuar me kontrata të ngjashme, të jetë rreth 30 % e vlerës (në vijimesi edhe me LLP të mëparshme) dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues do jete realisht në gjendje të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar si kompani sipas standardeve ndërkombëtare me:

- a) **ISO 9001:2015 ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme).**
- b) **ISO 27001:2013 ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme).**
- c) **ISO/IEC 20000-1:2018 ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme)**
- d) **ISO 14001:2015 ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit mjedisor (e vlefshme)**

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operationale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

- c) Certifikimi **ISO 9001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese.
- d) Certifikimi **ISO 27001:2013** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe që kanë një rëndësi dhe konfidencialitet të lartë, të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesit të këto sisteme të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Kjo vjen pasi në këtë kontrate do të ketë vijim të mirëmbajtjes dhe garancisë së suportit të të dy sistemeve ekzistuese që kërkojnë kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike, për aq sa ekspozohen sistemet në fjalë.
- e) Certifikimi **ISO 20001-1:2018** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të dy sistemet që kërkohen në DST, të cilët janë tërësisht të bazuar në produkte TIK (software dhe hardware), pasi duhet garanci dhe siguri maksimale edhe në kategorinë e mbrojtjes kibernetike.
- f) Certifikimi **ISO 14001:2015** ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është vetë konform kërkesave të sistemit të menaxhimit mjedisor dhe si i tillë krijohet besimi që është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në ambjentet e brendshme të autoritetit kontraktor me të njëjtat standarte dhe konform kërkesave për të ruajtur apo përmirësuar performancën mjedisore, objektivat mjedisore për sistemet ekzistuese dhe ato që do blihen rishtasi, pasi shtrirja e tyre gjeografike është e madhe dhe impakti mjedisor është i konsiderueshëm.

2.3.3 Operatori ekonomik/ Ofruesi i shërbimit duhet të paraqesë licencë (Autorizim) të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për transmetim të dhënash si dhe lejen e përdorimit të frekuencave (Autorizimin) nga AKEP, nëse do të përdoren (transmetim wireless).

Argumentimi: Licenca (autorizimi) garanton të drejtën e Operatorit Ekonomik për të ushtruar aktivitetin përkatës në Republikën e Shqipërisë.

2.3.4 Operatori ekonomik/Ofruesi i shërbimit duhet të paraqesë zgjidhjen teknike dhe bllok skemën e plotë për zgjidhjen e ofruar, ku përshkruhen në detaj teknologjitë e përdorura. Për teknologjinë që operatori ekonomik do të përdorë, duhet të paraqesë licencën përkatëse të lëshuar nga AKEP.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm i jep mundësi OSHEE Group sh.a. të ketë info të plotë mbi teknologjinë dhe mënyrën e lidhjes së pikave. Licenca përkatëse konfirmon të drejtën e Operatorit Ekonomik për të ofruar shërbimin në fjalë.

2.3.5 Ofruesi i shërbimit duhet të deklarojë që do të jetë i gatshëm për zhvendosjen fizike të lidhjeve online të pikave të OSHEE sh.a dhe bijave, ose ndarjen e kapacitetit të një linje, në linja të veçanta në vendndodhje të ndryshme me kusht që shumatorja e kapaciteteve të jetë e njëjtë me kapacitetin e linjës së mëparshme, kur kjo kërkohet nga kompania OSHEE sh.a. Shpenzimet për këto zhvendosje dhe ndarje kapaciteti do të mbulohen nga ofruesi i shërbimit. Për këto qëllim duhet të paraqitet një deklaratë nga ana e administratorit të operatorit ekonomik.

Argumentimi: OSHEE sh.a. Group kryen shpesh zhvendosje të zyrave dhe ndryshime në kapacitete, kështu që ofruesi i shërbimit duhet të garantojë kryerjen e këtij shërbimi.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të sigurojë mbrojtje nga sulmet DDoS. Mbrojtja nga sulmet DDoS do të ofrohet për linjen e internetit në site primar dhe sekondar nëpërmjet monitorimit, njoftimit dhe pastrimit automatik të sulmeve DDoS që trafikohen në rrjetin e Institucionit duke ofruar kështu: mbrojtje të serverit, mbrojtje të infrastruktures BGP, mbrojtje në baze volumetrike, mbrojtje në bazë aplikacioni dhe në bazë protokolli, kjo do të realizohet duke ndërtuar automatikisht një rrugëzim (routing) të trafikut drejt një “Scrubbing Center” qendërzim pastrimi, i cili duhet të ketë lidhje Intranet Layer 2 të brendshme nga operatori ekonomik për të rrugëzuar të gjithë trafikun në rast sulmesh. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë qendër Monitorim 24/7 për këtë shërbim-me duke specifikuar me skemat perkatëse se si do të realizohet. Operatori duhet të provojë me dokument specifik modelin dhe metodikën e mbrojtjes, për çdo model, pajisjet e përfshira, topologjinë e rrjetit të tij dhe përfshirjen e DDoS node në këtë topologji, platformën e cila e realizon këtë mbrojtje si dhe duhet të ofrojë një user me të drejta të kufizuara vetëm për monitorim të trafikut të ofruar dhe mënyrës së mbrojtjes.

Argumentimi: Në kushtet aktuale, ku siguria kibernetike ka marrë një rëndësi të veçantë, ofrimi i specializuar i shërbimit DDoS është jetik për ofrimin e shërbimeve të OSHEE group sh.a. Për më tepër disa shërbime të ofruara nga OSHEE sh.a. janë listuar si shërbime kritike për sigurinë kombëtare. Kriteri i mësipërm garanton mbrojtjen profesionale dhe automatike nga sulmet DDoS.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi 2 specialistë të fushës të certifikuar në mbrojtjen DDoS ose ekuivalente dhe të përfshirë në strukturën e sigurisë kibernetike. Për këta 2 punonjës Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat përkatëse.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të*

dorëzuar në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

Argumentimi: Kriteri për të paktën 2 specialiste të certifikuar dhe të përfshirë në sigurinë kibernetike garanton kapacitetin njerëzor të Operatorit Ekonomik për të ofruar mbrojtjen nga DDoS.

2.3.8 Operatori Ekonomik /Ofruesi i shërbimit duhet të paraqese vërtetim nga AKEP për të vërtetuar prezencën e rrjetit tokesor të OE në të gjitha rajonet ku kërkon shërbim OSHEE sh.a. (11 rajone- Shkodër, Burrel, Kukës, Tiranë, Durrës, Elbasan, Berat, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë). Ky rrjet duhet të jetë i publikuar pranë Regjistrat Elektronik të Rrjeteve Publike të Komunikimeve Elektronike (ATLAS).

Argumentimi: Zyrtarët e OSHEE sh.a. janë prezentë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ku pikat kryesore me më shumë punonjës janë në Drejtoritë Rajonale të përmendura më sipër. Këto pika janë të lidhura me Infrastrukturën Qendrore Kompjuterike me teknologjinë DMVPN. Prania e drejtpërdrejtë e rrjetit të Operatorit Ekonomik në këto rajone është thelbësore, pasi garanton rrjet të sigurt.

2.3.9 Operatori Ekonomik/Ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë një linjë telefonike me kapacitet 30 kanale për shërbimin e call center të OSHEE.

Argumentimi: OSHEE sh.a. parashikon të modernizojë dhe zgjerojë shërbimin e Call Center, ndaj lind nevoja e një numri të madh kanalesh (30).

2.3.10 Operatori Ekonomik/Shërbimi SIP do të ofrohet over IP nga Operatori Ekonomik në të njëjtën linjë fizike të Zyrtarëve Qendrore.

Argumentimi: Ofrimi i shërbimit në të njëjtën linjë fizike garanton cilësinë dhe disponibilitetin e shërbimit.

2.3.11 Operatori Ekonomik/Ofruesi i shërbimit duhet të ketë të punësuar të paktën 3 inxhinierë të certifikuar si më poshtë:

- **3 (tre) inxhinierë të certifikuar CCNA ose ekuivalente.**

Për këta 3 punonjës Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikatat përkatëse të kualifikimit;
- Diplomën e studimeve Universitare të nivelit të paktën bachelor në elektronikë, telekomunikacion, shkenca kompjuterike, informatike ose fusha të ngjashme.
- Të jenë në liste pagesa E-sig të pakten muajin e fundit.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi: kërkesa për certifikimin e mësipërm lind nga nevoja për të patur një shërbim të sigurt, profesional dhe cilësor, duke marrë parasysh edhe gamën e gjerë të shërbimeve që do të ofrohen: DMVPN, internet, BGP, VoIP etj.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 80 punonjës, nga te cilët te paktën 20 janë diplomuar në elektronikë, telekomunikacion, shkenca kompjuterike, informatike ose fusha të ngjashme. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Kjo të provohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Diplomën e studimeve universitare në elektronikë, telekomunikacion, shkenca kompjuterike, informatike ose fusha të ngjashme për 20 punonjësit e kerkuar.
- Të jenë në liste pagesa E-sig të pakten muajin e fundit.

Sqarim : përmbushja e kësaj kërkesë në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi: Numri minimal i punonjësve të kompanisë 80, lind nga numri i madh i pikave ku do të ofrohen shërbimet si dhe shpërndarja e gjerë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Duke

qenë se shërbimi i ofruar kërkon ekspertizë në fushën e komunikimeve elektronike është përcaktuar një numër minimal prej 20 personash që kanë ekspertizë të dokumentuar në këto shërbime, pra diplomim në fushat lartpërmendura.

2.3.13 Ofruesi i shërbimit duhet të deklarojë se do ti ofrojë kompanisë OSHEE sh.a. komunikim telefonik fiks për thirrjet kombëtare, sipas kërkesës së saj. Operatori ekonomik për ofrimin e këtij shërbimi duhet të paraqesë licence të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e shërbimit telefonik. Operatori Ekonomik duhet të garantojë portimin e numrave fiks jo më shumë se një javë nga lidhja e kontratës. Për këtë të paraqesë planin e portimit të numrave.

Argumentimi: Afati kohor i portimit të numrave 1javë është vendosur për të garantuar vijimin e shërbimit telefonik aktual.

2.3.14 Ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë dark fiber për lidhjen e Zyrave Qendrore me site sekondar në Tiranë dhe DR site në Vlorë (të paraqitet deklaratë angazhimi dhe skemën e lidhjes).

Argumentimi: Lidhje me dark fiber midis 2 vendndodhjeve të mësipërme garanton lidhjen e sigurt dhe me kapacitet të lartë që është thelbësore.

2.3.15 Ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë 2 blloqe nga 16 IP për t'u përdorur nga OSHEE sh.a. (të paraqitet deklaratë angazhimi).

Argumentimi: Numri i mësipërm i IP publike duhet për të siguruar funksionimin e shërbimeve: e mail, VPN, dalje në internet, aksesimin e faqeve web etj.

2.3.16 Afati i implementimit të kontratës është 15 ditë (per kete të paraqitet deklaratë nga administrator i operatorit ofertues).

Argumentimi: Shërbimet e përfshira në këtë kontratë janë jetike për aktivitetin ekonomik të OSHEE Group sh.a, kështu që implementimi i kësaj kontrate duhet kryer para përfundimit të të kontratës së mëparshme.

SHENIM: Nje punonjes mund te kete 1 ose disa certifikime

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si

dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termat e References dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdher te posacem nga titullari, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per sherbimet objekt procedure prokurimi, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.

SHENIM: ne respektim te nenit 36 te LPP sqarojme se kudo ku perdoret/përmendet, markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.